REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

3204

Maliq,më 19.6.2025

PROJEKT –VENDIM - Nr. 7

Për

" Rishpërndarjen e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025 "

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjene fondeve buxhetore", , te ligjit Nr 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", mbështetur në vendimin nr130 dt 26.12.2024 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 " Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 2 Datë 24.01.2025 Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025 », propozoj miratimin e këtij projekt –vendimi nga këshilli duke vendosur :

1-Të miratojë rishikimin e buxhetit për vitin 2025 si më poshtë :

Pakësim

Gr	Kap	Kod prog	llog ek	kodi	Objekti	vlera në lekë
00	01	01110	600	9999999	Paga	1,780,000
00	01	01110	601	9999999	Sigurime shoqerore	100,000

Shtesa :

00	01	06260	600	9999999	Paga	1,780,000
00	01	06260	601	9999999	Sigurime shoqerore	100,000

2.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

Konceptoi : A.Muka

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
Drejtoria e Finances dheBuxhetit

3201

Maliq me 18.6. **.2025**

R E L A C I O N

"Për rishpërndarjen e fondeve në Buxhetin e Bashkisë Maliq viti 2025 "

Të nderuar këshilltarë të Këshillit të Bashkisë Maliq!

Ju bëjmë me dije se në buxhetin e vitit 2025 është miratuar numri i punonjësve dhe fondi i pagave për cdo strukturë në Bashki.Gjate 6 mujorit janë bërë ndryshime si në dhe paga tek programi sektori mbështetës tek Bashika qëndër dhe Agjecia e Sherbimit Publik.
Për këtë kërkojme te bejme nje rishperndarje te buxhetit duke shpjeguar dhe arsyet si me poshte:
Me vendimin per Miratimin e buxhetit per vitin 2025,eshte miratuar sektori mbështetës tek Bashika gjithsej 9 punonjës, me një fond pagash prej 5,838mije lekë ,gjatë muajve janar dhe shkurt eshte bere pagesa ne kete strukture dhe per sektorin mbeshtetes të Agjencise se shërbimeve, detyrimet per muajin dhjetor 2024 dhe janar 2025 ,per paga,sigurime dhe shpërblime te ndryshme si dalje ne pension, shperblim fatkeqesi te cilat nuk ishin parashikuar në këtë program prandaj kërkojmë një shtesë fondi në strukturën e sektorit mbështetës pranë Bashkisë Maliq në vlerën 1,780 mijë lekë për paga dhe 100 mije lekë për sigurime shoqërore.
Pakësimin e fondit do e bejme tek struktura e aparatit të bashkisë në vlerën 1,780 mijë lekë për paga dhe 100 mije lekë për sigurime shoqërore ,pasi ketu kemi teperice fondi pasi nuk eshte plotesuar e gjithe struktura ka vende vakante ,si rrjedhim kemi teperice te fondit
Për këtë i drejtohemi Keshillit bashkiak të na miratoje këtë Projekt vendim per nje rishperndarje ne Buxhetin e vitit 2025, sipas strukturave dhe grupeve .

Konceptoi:
Almira Muka
Genci Floqi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ